



REPUBLIKA E KOSOVËS			
KOMUNA GLLOGOC			
GLLOGOC MUNICIPALITY			
Pranuar		26.09	2013
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
12	031-	19359	



REPUBLIKA E KOSOVËS
Zyra e Kuvendit të Komunës

Në vështrim të nenit 12 dhe 40 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale, nenit 34 pika 34.6) të Statutit të Komunës së Drenasit, Kuvendi i Komunës të Drenasit në mbledhjen e radhës të mbajtur më dt. 20.09.2013 miraton këtë:

V E N D I M
PËR PLOTËSIMIN E STATUTIT TË KOMUNËS

- I. APROVOHET iniciativa e Kryetarit të Komunës mbi plotësimin e nenit 76.3 të Statutit të Komunës së Drenasit i miratuar nga ana e Kuvendit të Komunës me 16.09.2009 për shqyrtim fillestar dhe tani ky nen plotësohet me këtë përmbajtje:

Në Zyrën Kryetarit të Komunës do të funksionojnë përveç zyrave të parapara me nenin 76.3 të Statutit të Komunës edhe dy zyra të reja e atë:

-Zyra Komunale për Komunitete e Kthim,

-Zyra Ligjore dhe e Personelit dhe

-Ndërsa Zyra e personelit-Sekretaria fshihet nga ky nen.

-Neni 76.3 të Statutit të Komunës do të ndryshohet me këtë plotësim.

- II. Ky Vendim do të jetë pjesë përbërëse e Statutit të Komunës i miratuar nga Kuvendi i Komunës me datën 16.09.2009.

III. Zbatimin e këtij Vendimi e benë Kryetari i Komunës ndërsa për implementimin e tij kujdeset Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Drenasit.

IV. Ky Vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Drenasit ndërsa do të aplikohet 15 ditë pas dorëzimit për vërtetimin e ligjshmërisë në MAPL.

Drenas, më 23.09.2013



Kryesuesi i Kuvendit

Naim Bazaj